



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr.11, datë 30.07.2024

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES NR. 575 PROT., DATË
12.12.2018 PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR
PRODHIM HIDROENERGJIK, SHOQËRISË
“BREÇANI-R.O.S.P” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtime në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike me Nr.575 prot., datë 12.12.2018 miratuar nga KBU Drin-Bunë me Vendim Nr.1, datë 11.12.2018 “HEC Drita”, subjektit “BREÇANI-R.O.S.P” sh.p.k., me vendndodhje, lumi i Gashit, Njësia Administrative Tropojë, Bashkia Tropojë, sipas këtyre koordinatave:

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujqor (Lumi i Gashit)

HEC Drita

Vepra e marrjes, koordinatat në KRGJSH

- X= 507917
- Y= 4695431
- Z= 312 m.m.n.d

Godina e Centralit

Pika e shkarkimit, koordinatat në KRGJSH

- X= 508057
- Y= 4693585
- Z= 248.5 m.m.n.d

- Qmes=2.59 m³/s
- Qllog=4.2 m³/s
- Qeko=0.14 m³/s

- Fuqia max e instaluar N = 1980 kW
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike E = 7 031 971 kWh/vit.

3. Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim hidroenergjetik jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

4. Ngarkohet Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

